



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, për subvencionet në fushën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Podujevës shpallë:

FTESË PUBLIKE

PËR APLIKIM NË PROJEKTIN:
PËRKRAHJE ME FEFERONA

Përfitues: 10 fermerë me nga 500 €

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

1. *Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;*
2. *Çertifikata e bashkësisë familjare;*
3. *Vërtetimi i tatimit në pronë;*
4. *Fletëposedimi (origjinal) për patundshmëri;*
5. *Dokument zyrtar i cili dëshmon se aplikuesi është i pa punë.*

Përparësit:

Poena

- | | |
|---|----|
| 1. Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar në ndonjë projekt në 3 vitet e fundit | 10 |
| 2. Aplikuesi që nuk është i punësuar | 10 |
| 3. Fermerët të cilët janë kultivues të perimeve | 10 |
| 4. Numri i antarëve të familjes (për çdo anëtar 5 poena) | |

Sqarim:

- Fermerët aplikues duhet të kenë së paku 20 ari sipërfaqe me perimkulturë;
- Mbjellja e fidaneve duhet të jetë sipas kriterëve agroteknike nga 10,000 deri 13,000 fidane në 20 ari;
- Pjesa tjetër e investimit të bëhet nga vetë fermerët;
- Përfituesit duhet të sjellin faturen e rregullt për blerjen e fidaneve të feferonave;
- Pagesa do të bëhet pas konstatimit të organit përkatës komunal pasi të jenë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara;
- Pas furnizimit me fidane dhe mbjelljes së tyre nga ana e përfituesit do të realizohet pagesa;
- Vlera maximale që do të paguhet është 500 € për një fermer;

Koha dhe vendi i mbjelljes:


- Mbjellja e feferonave duhet të bëhet në Pranverë;
- Kultivimi i feferonave do të bëhet në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyren e Shërbimit të Qytetarëve.

Afati i aplikimit është deri me datë 15.03.2024, në ora 16:00

Nr: 12-320/01-0013313/24

Podujevë, 26.02.2024



Shkurt, 2024